



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ANISA G. DIZDARI  
ADRESA NR.8, RR. E DIBRES  
TEL: 674918281

# PËRPILIM DHE VËRTETIM TË SH.P.K.-VE

(AKT THEMELI DHE STATUT)

Nr. repertori: 2155

Nr. koleksioni: 1008


Tirane më 27/10/2020

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Notarinë"



A2020050590087927231



Taksa e Pullës  
U PAGUA



A2020050590087927231

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"FALKAT" SH.P.K.**

Sot më datë 27.10.2020 (Dymijë e njëzetë) në Tiranë përpara meje **Noteres Anisa G. Dizdari**, Notere e Dhomës së Noterëve Tiranë, me Liçensë Nr.238, me NIPT L31925014A, që ushtron aktivitetin në studion e ndodhur në adresën Rr. "Dibrës", Nr.277, Tiranë u paraqitën personat e mëposhtëm:

z. **Arben Mlika**, i biri i Bajramit, lindur në Lezhë, ALB, i datëlindjes 01.01.1971, banues në Tiranë në adresën Rr. "4 Dëshmorët; Nd. 0, Njësia Administrative Nr. 8; shtetas shqiptar, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me anë të Kartës së Identitetit me Nr.Letërnjoftimi 035385846 dhe Nr.Personal H10101139A,

z. **Xhoslin Shata**, i biri i Seferit, lindur në Tiranë, ALB, i datëlindjes 21.07.1997, banues në Tiranë në adresën Labinoti; Nd. P.4; H. Shk.2; Ap. Ap.12; Njësia Administrative Nr. 1; shtetas shqiptar, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me anë të Kartës së Identitetit me Nr.Letërnjoftimi 033475158 dhe Nr.Personal J70721059T.

të cilët kanë vendosur të nënshkruajnë Aktin e Themelimit dhe Statutin e mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi, Akti i Themelimit dhe ky Statut.

**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"FALKAT" SH.P.K.**

**Neni 1 - Emërtimi**

Emërtimi i Shoqërisë është "FALKAT" SH.P.K.

**Neni 2 - Selia**

Selia e Shoqërisë është në Rr. "Haxhi H. Dalliu" kati 2, ap. B2-3/2, Tiranë, Shqipëri.



### Neni 3 - Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë e pakufizuar.

### Neni 4 – Objekti i shoqërisë

- 4.1 Objekti, i Shoqërisë: Shoqëria do të kryejë aktivitetin e tregtimit, importit, eksportit me shumicë dhe pakicë të materialeve e pajisjeve elektrike, elektronike, informatike, audio, pajisjeve industriale, sistemeve të sigurisë, pajisje laboratorike, pajisjeve e sistemeve/implianteve të tejra të ftohjes e ngrohjes (kondicionimit), si dhe implianteve të tjera të çfarëdo lloji. Projektim dhe instalim i implianteve të tjera elektrike, pajisje laboratorike, industriale, sistemeve të ftohjes e ngrohjes (kondicionimit), si dhe implianteve të tjera të çfarëdo lloji në vendet e ushtrimit të aktivitetit dhe jashtë tyre në objekte të ndryshme. Shërbime mirëmbajtje dhe servisi të ndryshëm për materiale e pajisje elektrike, pajisje industriale e elektroshtëpiake, pajisje laboratorike, pajisje dhe sisteme të ftohjes e ngrohjes (kondicionimit), si dhe për impliante të tjera të çfarëdo lloji në vendet e ushtrimit të aktivitetit dhe jashtë tyre në objekte të ndryshme.
- 4.2 Shërbime konsulence në lidhje me materialet elektrike, pajisjet industriale e elektroshtëpiake, pajisje laboratorike, pajisjet dhe sistemet/impliantet e ftohjes dhe të ngrohjes (kondicionimit), impliantet e tjera të çfarëdo lloji, si dhe supervizionin në lidhje me instalimin e tyre. Studime fizibiliteti në fushën e ekspertizës së shoqërisë.
- 4.3 Shoqëria do të kryejë gjithashtu aktivitetin në fushën e ndërtimit, studimin, projektimin, konsulencën, sipërmartjen zbatuese dhe/ose investimin sipas rastit, për realizimin me fonde publike dhe/ose administrimi, publike dhe/ose private si: punimin dhe gërmimin në tokë, ndërtimin e ndërtesave civile dhe industriale publike ose private, centraleve dhe objekteve turistike, objekteve të kultit, rrjetet inxhinierike, objektet industriale, të gjitha restaurimet dhe rikostruksionet dhe mirëmbajtjet e godinave civile e industriale, veshje e fasadave në përgjithësi; ndërtimin dhe rikostruksionin e rrugëve, autostradave, mbikalimeve, hekurudha e tramvai, metrove e pistave aeroportuale; ndërtimin dhe mirëmbajtjen e implianteve të prodhimit të energjisë elektrike, ndërtimet e nënstacioneve, kabinat e transformatorëve linja TN e të mesëm dhe shpërndarje të energjisë; rikostruksionin e veprave të artit, montimet e konstruksionet metalike, si dhe çdo ndërtim tjetër, i cili në përfundim, përbën send të paluajtshëm.
- 4.4. Shoqëria, në mënyrë dytësore dhe jo në mënyrë të drejtpërdrejtë, dhe sidoqoftë vetëm për të përmbushur objektin e saj tregtar, mund të kryejë çdo veprimtari tregtare, e cila do të konsiderohet si e nevojshme dhe e domosdoshme duke përfshirë edhe zotërimin e kuotave ose pjesëmarrjeve në shoqëri të tjera tregtare që ushtrojnë aktivitet të ngjashëm me aktivitetin e ushtruar nga vetë. Të ideojë, planifikojë dhe zbatojë Rrjete elektrike, Rrjete data, Sisteme Survejimi dhe Sigurie të të gjitha llojeve, Rrjete telefonike IP dhe analoge, Sisteme Fonie të llojeve të ndryshme duke përfshirë pajisjet Hardware dhe Software e nevojshëm. Të ofrojë mirëmbajtje të përhershme, Shërbim Konsulence, Këshillimi dhe Trajnimi për Sistemet Informatike dhe çdo gjë tjetër e përmendur më sipër. Të ofrojë Shërbime lidhje Informatike online. Materiale të ndryshme kancelarie. Të kryejë tregtim me shumicë dhe/ose pakicë të të gjitha produkteve që shërbejnë për mirëmbajtje ambientesh. Të ofrojë transport ndërkombëtar dhe kombëtar për vete dhe për të tretë. Call Center, shërbime telefonike kryerjen e





shërbimeve të shitjes së produktit me one të video call, telefonatave dhe me anë të Telemarketing.

- 3.5. Në funksion të qëllimeve të mësipërme shoqëria mund të hyjë në tregje dhe operacione të ndryshme, të zotërojë pasuri të luajtshme e të paluajtshme dhe/ose pjesëmarrje në shoqëri të tjera tregtare.

Për kryerjen e aktiviteteve të mësipërme të shoqërisë, për të cilën do të nevojitet leja përkatëse shoqëria është e detyruar të pajiset paraprakisht me këtë leje nga organi kompetent.

### **Neni 5 – Kapitali themeltar**

- 5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 (një qind) lekë.
- 5.2. Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 2 (dy) kuota, të nënshkruara me vlerë nominale 50 lekë secila.

### **Neni 6 - Kontributet**

- 6.1 Kontributi në kapitalin e shoqërisë është ofruar si më poshtë:

z. Arben Mlika, shtetas shqiptar, lindur më 01.01.1971 në Lezhë, ALB rezident në Tiranë, Rr."4 Dëshmorët; Nd. 0, Njësia Administrative Nr.8, mbajtës i Kartës së Identitetit me Nr.Letërnjoftimi 035385846 dhe Nr.Personal H10101139A, do të ofrojë një kontribut në para të barabarte 50 (pesëdhjetë) lekë duke depozituar një vlerë të njëjtë në llogarinë e shoqërisë në formim e sipër.

z. Xhoslin Shata, shtetas shqiptar, lindur më 21.07.1997 në Tiranë, ALB rezident në Tiranë, Labinoti; Nd. P.4; H. Shk.2; Ap. Ap.12; Njësia Administrative Nr.1, mbajtës i Kartës së Identitetit me Nr.Letërnjoftimi 033475158 dhe Nr.Personal J70721059T, do të ofrojë një kontribut në para të barabarte 50 (pesëdhjetë) lekë duke depozituar një vlerë të njëjtë në llogarinë e shoqërisë në formim e sipër.

- 6.2. Sipas kontributeve të mësipërme:

Z. Arben Mlika i takon nje kuote, e cila përfaqëson 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë.

Z. Xhoslin Shata i takon nje kuote, e cila përfaqëson 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë.

### **Neni 7 – Transferimi i pjesëve të kapitalit**

Pjesët e kapitalit i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

### **Neni 8 – Administratorët**

- 8.1 Me këtë akt emërohet Administrator i Shoqërisë personi si më poshtë:

- Z. Arben Mlika



- 8.2 Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm, në përputhje me parashikimet e nenit 95 të ligjit nr. 9901, datë 14 prill 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe nenit 14 të Statutit..
- 8.3 Administratori është gjithashtu i autorizuar të veprojë në emër të Shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, si edhe ka të drejtë t'i delegojë kompetencat e tij personave të tjerë.

### Neni 9 – Gjuha

- 9.1 Ky Akt Themelimi është i përbërë nga 5 (pesë) kopje në gjuhën shqipe.

\* \* \*


Unë, Noteria ia lexova këtë Akt Themelimi me zë të lartë palëve, të cilët, e gjetën atë në përputhje të plotë me vullnetin e tyre. Ky Akt Themelimi nënshkruhet lirisht nga palët në praninë time dhe unë Noteria vërtetoj nënshkrimin e tyre sipas ligjit.

### PALËT

Arben Mllitca 

Xheslin SHAFIJA 

**NOTERE**  
**ANISA G. DIZDARI**





**STATUTI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"FALKAT" SH.P.K.**

**KAPITULLI I  
THEMELIMI, EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA**

**Neni 1 – Themelimi, Forma dhe Ortaket**

1.1. Sot me datë 27.10. 2020 ortakët themelues të shoqërisë kanë vendosur të krijojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar emërtimi i të cilës do të jetë "FALKAT" SH.P.K.

1.2. Shoqëria "FALKAT" SH.P.K. (më poshtë "Shoqëria") është e krijuar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar nga ortakët e mëposhtëm:

z. Arben Mlika, shtetas shqiptar, lindur më 01.01.1971 në Lezhë, ALB rezident në Tiranë, Rr."4 Dëshmorët; Nd. 0, Njësia Administrative Nr.8, mbajtës i Kartës së Identitetit me Nr.Letërnjoftimi 035385846 dhe Nr.Personal H10101139A, do të ofrojë një kontribut në para të barabartë me 50 (pesëdhjetë) Lekë.

z. Xhoslin Shata, shtetas shqiptar, lindur më 21.07.1997 në Tiranë, ALB rezident në Tiranë, Labinoti; Nd. P.4; H. Shk.2; Ap. Ap.12; Njësia Administrative Nr.1, mbajtës i Kartës së Identitetit me Nr.Letërnjoftimi 033475158 dhe Nr.Personal J70721059T, do të ofrojë një kontribut në para të barabartë me 50 (pesëdhjetë) Lekë.

1.3 Shoqëria do të funksionojë sipas legjislacionit shqiptar.

1.4 Statuti është në përputhje me legjislacionin shqiptar që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në të, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.

**Neni 2 – Emërtimi**

Emërtimi i Shoqërisë është "FALKAT" SH.P.K.

**Neni 3 – Objekti i shoqërisë**

3.1 Shoqëria ka si objekt: Shoqëria do të kryejë aktivitetin e tregimit, importit, eksportit me shumicë dhe pakicë të materialeve e pajisjeve elektrike, elektronike, informatike, audio, pajisjeve industriale, sistemeve të sigurisë, pajisje laboratorike, pajisjeve e sistemeve/impianeteve të tejsira të ftohjes e ngrohjes (kondicionimit), si dhe impianeteve të tjera të çfarëdo lloji. Projektim dhe instalim i impianeteve të tjera elektrike, pajisje laboratorike, industriale, sistemeve të ftohjes e ngrohjes (kondicionimit), si dhe impianeteve të tjera të çfarëdo lloji në vendet e ushtrimit të aktivitetit dhe jashtë tyre në objekte të





ndryshme. Shërbime mirëmbajtje dhe servisi të ndryshëm për materiale e pajisje elektrike, pajisje industriale e elektroshtëpiake, pajisje laboratorike, pajisje dhe sisteme të ftohjes e ngrohjes (kondicionimit), si dhe për impiante të tjera të çfarëdo lloji në vendet e ushtrimit të aktivitetit dhe jashtë tyre në objekte të ndryshme.

- 3.2 Shërbime konsulence në lidhje me materialet elektrike, pajisjet industriale e elektroshtëpiake, pajisje laboratorike, pajisjet dhe sistemet/impianetet e ftohjes dhe të ngrohjes (kondicionimit), impianetet e tjera të çfarëdo lloji, si dhe supervizionin në lidhje me instalimin e tyre. Studime fizibiliteti në fushën e ekspertizës së shoqërisë.
- 3.3 Shoqëria do të kryejë gjithashtu aktivitetin në fushën e ndërtimit, studimin, projektimin, konsulencën, sipërmarrjen zbatuese dhe/ose investimin sipas rastit, për realizimin me fonde publike dhe/ose administrimi, publike dhe/ose private si: punimin dhe gërmimin në tokë, ndërtimin e ndërtesave civile dhe industriale publike ose private, centraleve dhe objekteve turistike, objekteve të kultit, rrjetet inxhinierike, objektet industriale, të gjitha restaurimet dhe rikostruksionet dhe mirëmbajtjet e godinave civile e industriale, veshje e fasadave në përgjithësi; ndërtimin dhe rikostruksionin e rrugëve, autostradave, mbikalimeve, hekurudha e tramvai, metrove e pistave aeroportuale; ndërtimin dhe mirëmbajtjen e impianteve të prodhimit të energjisë elektrike, ndërtimet e nënstacioneve, kabinat e transformatorëve linja TN e të mesëm dhe shpërndarje të energjisë; rikostruksionin e veprave të artit, montimet e konstruksionet metalike, si dhe çdo ndërtim tjetër, i cili në përfundim, përbën send të paluajtshëm.
- 3.4. Shoqëria, në mënyrë dytësore dhe jo në mënyrë të drejtpërdrejtë, dhe sidoqoftë vetëm për të përmbushur objektin e saj tregtar, mund të kryejë çdo veprimtari tregtare, e cila do të konsiderohet si e nevojshme dhe e domosdoshme duke përfshirë edhe zotërimin e kuotave ose pjesëmarrjeve në shoqëri të tjera tregtare që ushtrojnë aktivitet të ngjashëm me aktivitetin e ushtruar nga vetë. Të ideojë, planifikojë dhe zbatojë Rrjete elektrike, Rrjete data, Sisteme Survejimi dhe Sigurie të të gjitha llojeve, Rrjete telefonike IP dhe analoge, Sisteme Fonia të llojeve të ndryshme duke përfshirë pajisjet Hardware dhe Software e nevojshëm. Të ofrojë mirëmbajtje të përhershme, Shërbim Konsulencë, Këshillimi dhe Trajnimi për Sistemet Informatike dhe çdo gjë tjetër e përmendur më sipër. Të ofrojë Shërbime lidhje Informatike online. Materiale të ndryshme kancelarie. Të kryejë tregtim me shumicë dhe/ose pakicë të të gjitha produkteve që shërbejnë për mirëmbajtje ambientesh. Të ofrojë transport ndërkombëtar dhe kombëtar për vete dhe për të tretë. Call Center, shërbime telefonike kryerjen e shërbimeve të shitjes së produktit me one të video call, telefonatave dhe me anë të Telemarketing.
- 3.5. Në funksion të qëllimeve të mësipërme shoqëria mund të hyjë në tregje dhe operacione të ndryshme, të zotërojë pasuri të luajtshme e të paluajtshme dhe/ose pjesëmarrje në shoqëri të tjera tregtare.

#### Neni 4 – Selia

- 4.1 Selia e Shoqërisë është në Rr. "Haxhi H. Dalliu" kati 2, ap. B2-3/2, Tiranë, Shqipëri.
- 4.2 Transferimi i selisë së Shoqërisë në një vend tjetër bëhet me vendimin e Asamblesë së Ortakëve.
- 4.3 Asambleja e Ortakëve mund të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë si edhe jashtë saj.

#### Neni 5 – Kohëzgjatja e veprimtarisë



- 5.1. Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë e pakufizuar.
- 5.2. Shoqëria mund të prishet përpara këtij afati ose mund të kuëzjojë kohëzgjatjen e saj me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

## KAPITULLI II

### KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA E KUOTAVE TË KAPITALIT

#### Neni 6 – Kapitali themeltar

- 6.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 (një qind) lekë, i cili do të shlyhet nga ortakët brenda 30 ditëve nga themelimi i shoqërisë.
- 6.2. Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 2 (dy) kuota.

#### Neni 7 - Kontributet

- 7.1 Kontributi në kapitalin e shoqërisë është ofruar si më poshtë:

z. Arben Mlika, shtetas shqiptar, lindur më 01.01.1971 në Lezhë, ALB rezident në Tiranë, Rr.“4 Dëshmorët; Nd. 0, Njësia Administrative Nr.8, mbajtës i Kartës së Identitetit me Nr.Letërnjoftimi 035385846 dhe Nr.Personal H10101139A, do ofrojë një kontribut në para të barabartë me 50 (pesëdhjetë) lekë duke depozituar një vlerë të njëjtë në llogarinë e shoqërisë brenda 30 ditëve nga themelimi i saj.

z. Xhoslin Shata, shtetas shqiptar, lindur më 21.07.1997 në Tiranë, ALB rezident në Tiranë, Labinoti; Nd. P.4; H. Shk.2; Ap. Ap.12; Njësia Administrative Nr.1, mbajtës i Kartës së Identitetit me Nr.Letërnjoftimi 033475158 dhe Nr.Personal J70721059T, do ofrojë një kontribut në para të barabartë me 50 (pesëdhjetë) lekë duke depozituar një vlerë të njëjtë në llogarinë e shoqërisë brenda 30 ditëve nga themelimi i saj.

- 7.2. Sipas kontributit të mësipërm:

Z.Arben Mlika i takon 1 (një) kuotë që përfaqëson 50 % (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë.  
Z.Xhoslin Shata i takon 1 (një) kuotë që përfaqëson 50 % (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë.

#### Neni 8 – Rritja e kapitalit themeltar

- 8.1 Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë.
- 8.2 Në rast rritjeje të kapitalit, kuotat e ortakëve të Shoqërisë do të rriten sipas shumave të përcaktuara në vendimin e asamblesë.

#### Neni 9 – Zvogëlimi i kapitalit themeltar

- 9.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendimin e Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga





9.2

Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakëve sipas shumave të përcaktuara në vendimin e asamblesë.

### **Neni 10 – Transferimi i kuotave të kapitalit dhe e drejta e parablerjes**

- 10.1 Kuotat e kapitalit janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, sipas neni 73 të ligjit 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”.
- 10.2 Në rast transferimi të kuotave të kapitalit në çdo lloj forme në favor të personave të tjerë, si me shpërblim ashtu edhe pa shpërblim, me çdo kusht, duke përfshirë edhe dhurimin, ortakët e tjerë gëzojnë të drejtën e parablerjes mbi këto kuota kapitali.
- 10.3 Në një rast të tillë ortaku që do të transferojë kuotat e tij të kapitalit duhet t'i njoftojë ortakët e tjerë, me letër rekomande me kthim përgjigje, mbi synimin për shitjen, çmimin, kushtet, modalitetet, emrin e blerësit dhe afatet e transferimit. E drejta e parablerjes i referohet të gjitha kuotave të kapitalit ofruar për shitje.
- 10.4 Ortakët do të kenë në dispozicion 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga marrja e letër rekomande, për t'i komunikuar ortakut që transferon kuotat e kapitalit, synimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, prezumohet se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.
- 10.5 Në rast se oferta pranohet nga disa ortakë, kuotat e kapitalit të ofruara nga ortaku që transferon kuotat e kapitalit, do të ndahen nga ortakët pranues, në të njëjtën masë me kuotat që ata zotërojnë, përveç rastit kur ka një marrëveshje të kundërt. Në asnjë rast, pranuesi i ofertës nuk mund të ushtrojë pjesërisht të drejtën e parablerjes.
- 10.6 Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, kuotat e kapitalit mund t'i transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht, me vendimin e Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë në kushtet e përcaktuara në pikën 11.4.
- 10.7 Në rast të transferimit të kuotave të kapitalit për shkak trashëgimie *mortis causa* ortakët e tjerë kanë të drejtë të shprehin pëlqimin e tyre për ortakët e rinj. Nëse ortakët e Shoqërisë nuk japin pëlqimin e tyre për ortakët e rinj kuotat e kapitalit mund t'i transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht, me vendimin e Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë.

### **KAPITULLI III**

### **ASAMBLEJA, ADMINISTRATORËT DHE EKSPERTI KONTABËL**

### **Neni 11 – Asambleja e ortakëve dhe kompetencat e saj**

- 11.1 Organi vendimmarrës i Shoqërisë është Asambleja e Ortakëve me anëtar ortakët e shoqërisë.
- 11.2 Vendimet e Asamblesë së Ortakëve, për të cilat kërkohet një shumice e thjeshtë, janë të vlefshme



nëse janë të pranishëm në mbledhje ortakët me të drejtë vote që përfaqësojnë me shume se 30% (tridhjetë për qind) të të gjithë kapitalit themeltar. Vendimet e Asamblesë së Ortakëve, për të cilat kërkohet një shumice e kualifikuar, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm në mbledhje ortakët që përfaqësojnë më shumë se 50% (pesëdhjetë për qind) të të gjithë kapitalit themeitar.

- 11.3 Nëse Asambleja nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në nenin 11.2 të këtij statuti, Asambleja do të mbledhet përsëri jo me vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend ditë.
- 11.4 Asambleja e Ortakëve vendos me shumicë të kualifikuar me tre të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 11.2, për ndryshimin e statudit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, transferimin e kuotës së kapitalit sipas pikës 10.6.
- 11.5 Në të gjitha rastet e tjera përpara parashikohet në ligj dhe në statut vendimet e tjera merrem me shumicë të thjesht me kuorumin që përcaktohet në pikën 11.2.

#### **Neni 12 – E drejta e pjesëmarrjes dhe e votës**

- 12.1 Çdo kuotë jep të drejtën e një vote.
- 12.2 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamble, të paraqesë mendimin e tij dhe të japë votën sa është përfaqësues i kapitalit të kuotës që ai zotëron.
- 12.3 Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër edhe jo-ortak, i pajisur me prokurë me shkrim, me anën e së cilës mund të japë votën e tij.
- 12.4 Ortaku nuk mund të lëshojë prokurë për votim për një pjesë të kuotave të kapitalit që zotëron, në qoftë se voton personalisht për pjesën e mbetur të kuotave.

#### **Neni 13 – Thirrja e Asamblesë së Ortakëve**

- 13.1 Asambleja e Ortakëve thirret të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e bilancit, të raportit të Administratorit, ekspertit kontabël si dhe inventarit.
- 13.2 Asambleja mund të thirret në çdo moment nga një prej Administratorëve ose nga një ose disa ortakëve që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë për qind) të kapitalit themeltar.
- 13.3 Asambleja duhet të thirret nëpërmjet njoftimit me letër rekomandë me kthim përgjigje dhe/ose postë elektronike që duhet t'u dërgohet ortakëve – në adresën që rezulton në Librin e Ortakëve – dhe ekspertit kontabël (nëse është emëruar), të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë. Thirrja duhet të përmbajë informacion mbi mbi çështjet që do të trajtohen dhe për të cilat do të merret vendim, mbi vendin, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë.
- 13.4 Asambleja mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë.





- 13.5 Mbledhjet e Asamblesë mund të mbahen edhe nëpërmjet telekonferencës dhe videokonferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe t'i lejohet atyre të ndjekin diskutimin dhe të ndërhyjnë në momentin e trajtimit të argumenteve; pasi të jenë verifikuar këto kërkesa që duhet të rezultojnë në procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari.
- 13.6 Asambleja do të thirret dhe mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit, në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të tërë kapitalin themeltar.
- 13.7 Çdo Asamble drejtohet nga një ortak ose ndonjë person tjetër i caktuar nga e njëjta Asamble i cili gjithashtu pasqyron dhe vendimet e marra në regjistrin e vendimeve të shoqërisë.
- 13.8 Të gjitha vendimet e Asamblesë regjistrohen në procesverbal në përputhje me nenin 90 të ligjit n. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

#### Neni 14 – Administrimi

- 14.1 Shoqëria administrohet nga të paktën 1 (një) Administrator dhe maksimumi 3 (tre) Administratorë, të cilët qëndrojnë në detyrë deri në revokimin apo dorëheqjen, për një periudhë maksimale prej 5 (pesë) vjetësh.
- 14.2 Përfaqësimi ligjor i Shoqërisë i besohet Administratorit. Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat sipas parashikimeve të nenit 95 të ligjit n. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- 14.3 Administratori i Shoqërisë për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e themelimit të shoqërisë është:

z. Arben Mlika, shtetas shqiptar, lindur më 01.01.1971 në Lezhë, ALB rezident në Tiranë, Rr."4 Dëshmorët; Nd. 0, Njësia Administrative Nr.8, mbajtës i Kartës së Identitetit me Nr.Letërnjoftimi 035385846 dhe Nr.Personal H10101139A.

- 14.4 Administratori mund të emërojë përfaqësues për kryerjen e veprimeve që ai është kompetent në bazë të statutit dhe ligjit.

#### Neni 15 – Eksperti kontabël i autorizuar

- 15.1 Në rast se kërkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Ortakëve, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë mund t'i besohet një eksperti kontabël të autorizuar.
- 15.2 Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

### KAPITULLI IV

#### VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE

#### Neni 16 - Viti financiar dhe bilanci vjetor



- 16.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit.
- 16.2 Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe përfundon më 31 dhjetor të të njëjtit vit.
- 16.3 Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar (nëse është emëruar) miratohen nga Asambleja me shumicën e përcaktuar sipas ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.
- 16.4 Miratimi i dokumenteve që lidhen me vitin financiar duhet të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve që nga fundi i vitit financiar.

#### Neni 17 – Fitimet

- 17.1 Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, duke zbritur 5% (pesë për qind) që caktohen për rezervën ligjore deri në 10% (dhjetë për qind) e kapitalit themeltar, dhe duke zbritur gjithashtu të gjitha shumat që Asambleja vendos t'i vërë mënjane, u shpërndahen ortakëve në proporcion me kuotat e kapitalit themeltar të zotëruara.
- 17.2 Asambleja mund të vendosë edhe zbritje të veçanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo dhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.

### KAPITULLI V SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

#### Neni 18 – Prishja

- 18.1 Shoqëria priset me përfundimin e afatit të parashikuar nga Statuti, ose përpara përfundimit në rastet e parashikuara nga ligji, ose me anë të një vendimi të Asamblesë së Ortakëve, me shumicën e kërkuar për ndryshimet në statut.
- 18.2 Shoqëria nuk priset në rast të humbjes së zotësisë për të vepruar, pazotësisë juridike, vdekjes, ose falimentimit të ortakëve.

#### Neni 19 – Likuidimi

- 19.1 Në rast prishje, Shoqëria duhet të likuidohet.
- 19.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.
- 19.3 Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja do të vendosë mbi bilancin financiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likuiduesi dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.
- 19.4 Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do t'i shpërndajë të ardhurat





përfundimtare të likuidimit ortakëve, në proporcion me kuotat e kapitalit të zotëruara prej tyre në kapitalin themeltar.

### Neni 20 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 20.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statuti dhe aktit të themelimit, si edhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve (përveç atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.
- 20.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ato do t'i besohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

### Neni 21 – Gjuha

- 20.1 Ky statut është i përbërë nga 5 (pesë) kopje në gjuhën shqipe.
- 20.2 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statuti dhe aktit të themelimit, versioni në gjuhën shqipe do të jetë i vetmi ligjërishit i pranueshëm.


\* \* \*

Unë, Noteria, ia lexova ortakëve këtë Statut me zë të lartë dhe ta, e gjejnë atë në përputhje të plotë me vullnetin e tyre. Ky Statut nënshkruhet lirisht prej tyre në praninë time, dhe unë Noteri, vërtetoj nënshkrimin e tij sipas ligjit.

Këtij akti i bashkëlidhen kopjet e dokumentave të identifikimit.

Përsa më sipër, prej meje Noteres u hartua ky Akt Themelimi dhe Statut në gjuhën shqipe, në 5 (pesë) kopje origjinale dhe me përmbajtje të njëjtë. Në origjinalin e arshivës së mbajtur nga unë Noterja, aplikohet tarifa e pullës në vlerën 200 (dyqind) Lekë. Ky akt pasi iu lexua dhe iu shpjegua të lartëpërmenduarve dhe ata deklarojnë se janë dakort me përmbajtjen e saj, pasi në të është shprehur vullneti i tyre i lirë dhe i plotë, e nënshkruajtën atë para meje Noteres. Unë Noterja e vërtetoj këtë akt në bazë të Ligjit Nr.110, dt.20.12.2018 "Për Noterinë" në Republikën e Shqipërisë. Në zbatim të Ligjit Nr.9887, dt.10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij dokumenti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

z. Alban Mlika  


z. Xhasia SHIFA  


NOTERE  
 ANISA G. DIZDARI

